

VENDIM
Nr.340, datë 20.5.2005

PËR DHËNIE LICENCE

PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT “FOKUS”
SUBJEKTIT: SHOQËRIA “FOKUS CABLE” SH.P.K.

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, si dhe rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll” të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.221, datë 30.3.2004, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit shoqërisë “Fokus Cable” sh.p.k., licencë duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat, në fushën e transmetimeve të televizionit me kabëll, për të penetruar në qytetin e Maliqit, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj